



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 55, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.38/2015), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 30 mars 2017 miratoi:

## **RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe Fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj procedurat për funksionimin e Tribunalit të arbitrazhit.
2. Kjo rregullore aplikohet për siguruesit, policëmbajtësit, të siguarit dhe palët e treta .

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

Të gjithë termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: Ligji për Sigurimet) dhe /ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:

- a) *Arbitrazhi* nënkupton procedurën e zgjidhjes se kontesteve në të cilin një palë e tretë neutrale (arbitri) pas shqyrtimit të provave dhe fakteve nxjerrë një vendim lidhur me kontestin në fjalë.
- b) *Arbitri apo Arbitrat* nënkupton individin apo grupin e individëve (panelin) të caktuar me marrëveshje nga palët apo nga Gjykata për të zgjidhur kontestin.
- c) *Marrëveshja e Arbitrazhit* nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet palëve sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, që kontestet juridike, të cilat kanë lindur ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit.
- d) *Pala paditëse* është personi i cili ka të drejtë për të paditur dhe të kërkoj zgjidhjen apo pagesën e përfitimit apo përfitimeve të dhura nën kushtet dhe kriteret e kontratës së sigurimit. Palë paditëse, mund të jenë: policëmbajtësit, të siguarit dhe palët e treta përfituese.
- e) *Arbitrimi* nënkupton procedurën e zgjidhjes se një kontesti.
- f) *“Tribunal”* nënkupton tribunalin e arbitrazhit.

### **Neni 3**

#### **Marrëveshja e arbitrazhit**

1. Një mosmarrëveshje mund të zgjidhet përmes arbitrazhit vetëm nëse ekziston marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë që mosmarrëveshja të zgjidhet përmes arbitrazhit.
2. Marrëveshja për arbitrazhin është e vlefshme vetëm nëse është lidhur në formë të shkruar. Marrëveshja për arbitrazh konsiderohet e lidhur në formë të shkruar edhe kur është lidhur me këmbimin e letrave, telegrameve apo mjeteve tjera që e mundësojnë provën e shkruar mbi marrëveshjen e përfunduar.

### **Neni 4**

#### **Të drejtat e Paditësit në Procedurën e Arbitrazhit**

Pala paditëse ka të drejtë t'i drejtohet arbitrazhit pas shfrytëzimit të mjeteve juridike brenda Siguruesit, në të kundërtën padia do të hidhet poshtë si e parakohshme.

### **Neni 5**

#### **Juridiksioni i Tribunalit të arbitrazhit**

Në rast se është pranuar me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve, arbitrazhi mund t'i zgjidhë të gjitha çështjet, të cilat janë të lidhura me detyrimin nga një policë, siç mund të jetë trajtimi dhe rregullimi i dëmit dhe çështjet tjera të lidhura me kushtet e kontratës së sigurimit (policës).

### **Neni 6**

#### **Tribunali i arbitrazhit**

1. Mosmarrëveshjet që dalin nga apo në lidhje me një policë të sigurimeve, me pajtimin në mes të dy palëve mund të zgjidhet nga Tribunalet e Arbitrazhit, nëse parashihen në kuadër të marrëveshjes së palëve, në pajtim me Ligjin për Arbitrazhin.
2. Siguruesi duhet të hartoj dhe miratoj procedura të brendshme, si dhe duhet të publikoj informacionin për rregullat e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve.
3. Tribunali i arbitrazhit do të funksionojë si një zyrë për organizimin e seancave të arbitrazhit, do të mirëmbaj listën e arbitrave, do udhëheq funksione tjera të nevojshme për panelet e arbitrazhit, si dhe do të njoftoj palët me vendimet e panelit të arbitrazhit.

### **Neni 7**

#### **Lista e arbitrave**

1. Lista e arbitrave, do të përbëhet nga persona të aprovuar nga BQK-ja. Në rastet e kontestit, palët do të bëjnë për zgjedhjen e arbitrave sipas kësaj rregullore.

2. Personat e zgjedhur për listën e arbitrave duhet të jenë individë, të cilët përmbushin kriteret e BQK- për të qenë i përshtatshëm dhe i duhur, si dhe kërkesat e përcaktuara me Udhëzimin e BQK-së nr. 01/2015 të aplikueshme për drejtoret dhe menaxheret e larte te siguruesve si dhe të kenë njohuri adekuate dhe të jenë kompetent të gjykojnë çështjet të cilat lidhen me sigurime.
3. Arbitrat nuk duhet të jenë zyrtarë, punëtorë apo palë të ndërlidhura të siguruesit, ndërmjetësuesit të sigurimeve apo trajtuesit të dëmeve.

## **Neni 8**

### **Zgjedhja e Panelit të Arbitrazhit**

1. Paneli i arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm ose nga një trup arbitrash, me kusht që numri i arbitrave të këtij trupi të jetë tek.
2. Në rastin e lidhjes së marrëveshjes të palëve, me anë të cilës ata pranojnë që mosmarrëveshja të zgjidhet përmes arbitrazhit palët mund të pajtohen për procedurën e emërimit të arbitrit ose të arbitrave.
3. Nëse palët nuk pajtohen për numrin e arbitrave ose për procedurën e emërimit të tyre brenda 15 ditëve, pasi që i padituri të ketë pranuar njoftimin për arbitrazh, Tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga një trup prej 3 arbitrave, të cilët emërohen sipas paragrafit 4 të këtij neni.
4. Në rastin e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, secila palë emëron një arbitër. Dy arbitrat e emëruar e emërojnë arbitrin e tretë, i cili do të jetë drejtues i panelit të arbitrazhit. Nëse njëra palë nuk e emëron arbitrin brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i kërkesës për të bërë ketë ose nëse dy arbitrat nuk merren vesh për emërimin e arbitrit të tretë brenda tridhjetë (30) ditëve nga emërimi i tyre, atëherë me kërkesën e njëres palë arbitri përkatës emërohet nga Gjykata.
5. Për të zgjidhur rastet e kontesteve në shumë deri një mijë (1,000) euro ose më pak do të caktohet vetëm një arbitër.

## **Neni 9**

### **Procedura e përjashtimit të arbitrave**

1. Personi, të cilit njëra palë i drejtohet për emërim si arbitër, ka për detyrë t'i bëjë publike të gjitha rrethanat, të cilat mund të shkaktojnë dyshime lidhur me pa-anësinë ose pavarësinë e tij. Arbitri, pas emërimit, duhet t'i bëjë publike rrethanat e tilla para palëve nëse palët nuk janë njoftuar paraprakisht për këto rrethana.

2. Secila palë mund të kërkojë përjashtimin e cilitdo arbitër, nëse ajo ka dyshime të arsyeshme lidhur me pa-anësinë ose pavarësinë e arbitrit, ose nëse arbitri nuk i posedon kualifikimet, për të cilat palët janë pajtuar. Pala mund të kërkojë përjashtimin e arbitrit të cilin e ka emëruar ajo, vetëm nëse arsyet për përjashtimin e tij kanë lindur pas emërimit të arbitrit. Pala gjegjëse ka për detyrë të kërkojë përjashtimin e arbitrit menjëherë pasi të njoftohet për rrethanat të cilat e arsyetojnë përjashtimin.
3. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga emërimi i arbitrit ose pasi të jetë njoftuar për rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, pala e cila kërkon përjashtimin e një arbitri ka për detyrë, t'i dërgojë palës tjetër dhe anëtarëve tjerë të panelit një njoftim për përjashtimin. Njoftimi duhet të bëhet me shkrim dhe në të duhet të theksohen arsyet për përjashtim.
4. Nëse arbitri nuk jep dorëheqje ose pala tjetër nuk pajtohet me përjashtimin, Tribunali i arbitrazhit vendos mbi kërkesën për përjashtimin e arbitrit.
5. Nëse kërkesa për përjashtimin e arbitrit nuk është e suksesshme sipas procedurës së paraparë në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, atëherë pala përkatëse mund të paraqesë kërkesën për përjashtimin e arbitrit para Gjykatës brenda 15 ditëve prej ditës së pranimit të njoftimit për refuzimin e kërkesës për përjashtim. Kundër vendimit të Gjykatës nuk lejohet ankesa. Përderisa Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën, paneli i arbitrazhit, duke përfshirë edhe arbitrin përjashtimi i të cilit kërkohet, mund të vazhdojë me procedurën e arbitrazhit dhe të nxjerr vendim.

## **Neni 10**

### **Procedurat e arbitrazhit**

1. Palët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe secila palë duhet të ketë mundësinë e plotë që të paraqesë rastin e saj në secilën fazë të procedurës së arbitrazhit.
2. Palët janë të lira në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, të cilët do t'i përfaqësojnë ato në procedurën e arbitrazhit. Asnjë përfaqësues i autorizuar nga pala, nuk mund të përjashtohet nga procedura e arbitrazhit. Arbitrat mund të kërkojnë që palët t'i dorëzojnë dokumentet, të cilat i përshkruajnë detalet e palës paditëse dhe fakte tjera, për të cilat ata e konsiderojnë të nevojshme për ta sqaruar rastin.
3. Tribunali i arbitrazhit duhet të funksionoj sipas rregullave të procedurës së brendshme në pajtim me Ligjin mbi Arbitrazh si dhe Ligjin mbi Procedurën Kontestimore në fuqi, ose duke i zbatuar rregullat e arbitrazhit të një institucioni të arbitrazhit të përhershëm.

## **Neni 11**

### **Shpenzimet e procedurës së arbitrazhit**

1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit cakton shpenzimet në vendimin e tij përfundimtar. Shpenzimet në fjalë përfshijnë:
  - a) taksën e tribunalit të arbitrazhit;
  - b) shpenzimet e arbitrave;
  - c) shpenzimet për ekspertë dhe ndihmën tjetër të cilën e ka kërkuar tribunali i arbitrazhit dhe për të cilën janë pajtuar palët;
  - d) shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të dëshmitarëve, deri në masën e miratuar nga tribunali i arbitrazhit;
  - e) shpenzimet për përfaqësimin dhe ndihmën për palën e suksesshme, nëse kompensimi i këtyre shpenzimeve është kërkuar gjatë procedurës së arbitrazhit, dhe vetëm deri në atë masë që tribunali i arbitrazhit e cakton të arsyeshëm; dhe
  - f) të gjitha taksat dhe shpenzimet e gjykatës kur kjo bënë emërimin e arbitërve.
2. Taksat e tribunalit të arbitrazhit duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën e kontestit, kompleksitetin e lëndës, kohën e shpenzuar nga arbitrat dhe rrethanat e tjera të rastit. Në rast se shfaqen mosmarrëveshje në lidhje me shumën e taksave që duhet paguar tribunalit të arbitrazhit, gjykata është kompetente që të vendosë mbi këtë çështje.
3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, shpenzimet e arbitrazhit i ngarkohen palës humbëse. Tribunali i arbitrazhit mund të ndajë shpenzimet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni ndërmjet palëve, nëse konstaton se një ndarje e tillë është e arsyeshme duke marrë parasysh rrethanat e rastit.

## **Neni 12**

### **Njoftimi paraprak**

1. Të gjitha seancat e arbitrazhit kërkojnë së paku dhjetë (10) ditë njoftim paraprak për palët, përveç nëse për një njoftim të tillë është hequr dorë sipas nënshkrimit të palës, të cilës i është dedikuar njoftimi.
2. Njoftimi duhet t'u dërgohet palëve me postë apo me korrier, në atë mënyrë që palët të jenë të njoftuar dhjetë (10) ditë pasi që kontesti të jetë pranuar nga arbitrat.

## **Neni 13**

### **Pjesëmarrja e Palëve**

1. Tribunali i arbitrazhit duhet të bëjë përpjekje për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre të autorizuar, gjatë shqyrtimit të rastit. Tribunali mundet, nëse e konsideron të

nevojshme dhe të arsyeshme, ta deklarojnë mosparaqitjen e njëres palë dhe të fillojnë seancën e arbitrazhit në mungesë të palës, duke u siguruar se njoftimi paraprak është vërtetuar.

2. Nëse njëra palë, edhe pse ka qenë e nuk merr pjesë në seancën e dëgjimit ose nuk i dorëzon provat brenda afatit të caktuar, paneli i arbitrazhit mund ta vazhdojë procedurën e arbitrazhit dhe ta nxjerr vendimin në bazë të provave me të cilat disponon.

#### **Neni 14**

##### **Periudha e marrjes së vendimit**

Tribunali i arbitrazhit do të marr vendim me shkrim për rastin, brenda pesëmbdhjetë (15) ditëve, nga data kur shqyrtimi i rastit të ketë përfunduar.

#### **Neni 15**

##### **Regjistrimi i seancave**

1. Tribunali i arbitrazhit duhet t'i regjistrojë të gjitha dokumentet e pranuar nga palët në kontest, procesverbalet e seancave, vendimet e shkruara dhe arsyeshmërinë ligjore, mbi bazën e të cilit është marrë vendimi.
2. Regjistrimi i arbitrazhit do të mbahet si konfidencial nga Tribunali i arbitrazhit. Informacionet lidhur me arbitrazhin mund t'i jepen vetëm BQK-së me kërkesë të shkruar.

#### **Neni 16**

##### **Mbajtja e shënimeve**

Tribunali i arbitrazhit duhet t'i mbajë dhe t'i sigurojë shënimet e arbitrazhit për një periudhë prej së paku pesë (5) vite nga data e vendimit.

#### **Neni 17**

##### **Vendimi i arbitrazhit**

1. Vendimi i tribunalit të arbitrazhit nxirret në formë të shkruar dhe është përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët. Vendimi për palët e ka efektin e njëjtë juridik sikurse një aktgjykim i plotfuqishëm dhe detyrues i gjykatës.
2. Në vendim ceken arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, përveç nëse palët janë pajtuar që arsyet të mos ceken.
3. Vendimi nënshkruhet nga arbitri ose arbitrat, dhe mbanë datën dhe vendin kur është nxjerrë. Në procedurën e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, nënshkrimet e shumicës së

anëtarëve të tribunalit janë të mjaftueshme, me kusht që në vendim të shpjegohen arsyet për mungesën e nënshkrimeve të tjera.

4. Nga një kopje e vendimit të nënshkruar nga arbitrat u dorëzohet të dyja palëve, pasi që të jenë paguar të gjitha taksat.
5. Vendimi bëhet publik vetëm me pëlqimin e të gjitha palëve.

### **Neni 18**

#### **Mjetet juridike**

Kundër vendimit të panelit të arbitrazhit, palët relevante kanë të drejtë ushtrojnë mjetet juridike siç është përcaktuar me nenin 36 të Ligjit Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin.

### **Neni 19**

#### **Raportimi në BQK**

Për qëllime të BQK-së, Tribunalet e arbitrazhit duhet të dorëzojnë në BQK, një raport për vendimet e marra të arbitrazhit për sigurimet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëshit të parë të muajit janar, prill, korrik dhe tetor, të çdo viti.

### **Neni 20**

#### **Aplikimi i dispozitave tjera rregullative**

Për çështjet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë rregullore do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin.

### **Neni 21**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të shfuqizohet Rregulli 10 mbi Ndryshimin e Rregullores Mbi themelimin e Forumit të Arbitrazhit të datës 29 korrik 2008.

### **Neni 22**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit të saj nga Bordi i BQK-së.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci